

DREJTORIA E INSPEKSIONIT

RAPORTI TRE MUJOR JANAR - MARS 2023

Sfera e ndërtimit

Në këtë sferë për tremujorin e parë të vitit 2023 janë shqiptuar më pak gjoba si dhe objektet janë pajisur me më shumë leje ndërtimi, për arsye të vetëdijesimit të qytetarëve nga aktiviteti i lartë i inspektorëve edhe përkundër pamjaftueshmërisë së stafit.

- | | |
|---|----------------------------|
| - TM1/2023 janë 20 leje ndërtimi | ndërsa në TM1/2022 vetëm 1 |
| - TM1/2023 janë 3 gjoba | ndërsa në TM1/2022 janë 14 |
| - TM1/2023 janë 2 aktvendime për ndërprerje të punimeve | ndërsa në TM1/2022 janë 15 |
| - TM1/2023 janë 110 përgjigje ndaj kërkesave | ndërsa në TM1/2022 janë 88 |

Ndërtimet e larta janë të gjitha nën kontroll,

Për çdo etazhitet kërkohen matjet gjeodezike,

Përcjellja e vazhdueshme e ndërtimeve nga inspektorët është duke ndikuar në mënyrë të drejtpërdrejt në ngritjen e cilësisë së ndërtimit,

Është ngritur vetëdijesimi i qytetarëve për t'u pajisur me leje të ndërtimit

Sfera e Tregut

Gjatë TM1/2023 inspektorët janë fokusuar në identifikimin dhe regjistrimin e bizneseve të reja,

Janë inspektuar bizneset për ndryshim të çmimeve raft-arkë nga ankesat e qytetarëve,

Në bashkëpunim me MINT –Departamenti i Metrologjisë janë inspektuar furrat e bukës për peshën dhe deklaracionin e bukës, ku janë gjetur parregullsi dhe ndëshkuar me gjoba

Janë inspektuar 150 biznese

Janë shqyrtuar 62 pranime për kushtet minimal-teknike

Të hyrat në këtë sferë janë 5,800€

Sfera e Shërbimeve Publike

Bazuar në planin e punës së kësaj sfere gjatë kësaj periudhe kryesisht janë inspektuar:

- shfrytëzimi i hapësirave publike,
- ndërhyrjet në infrastrukturën publike,
- kycje në rrjetin e kanalizimit dhe ujësjellësit

Të njëjtat kanë bashkëpunuar

- me inspektorin e Komunikacionit në inspektimin e bartjes publike të udhëtarëve dhe të transportit,
- me inspektorët e Mjedisit në inspektimin e objekteve të cilat duhet të pajisen me Leje Mjedisore,
- me inspektorët e Tregut në inspektim e lokaleve afariste për përmbushjen e kushteve minimale teknike, në shqyrtimin e kërkesave të palëve, etj

Janë shqiptuar 8 gjoba mandatore:

- 1 objekt reklamues është larguar,
- 2 rrethoja janë larguar,
- 1 kioskë është larguar,
- 30 procesverbale të hartuara,
- 13 ankesa të shqyrtuara.

Sfera e komunikacionit

Është marrë me inspektimin e bartjes publike të udhëtarëve me autobus,

- me inspektimin e bartjes publike të udhëtarëve me taksì,
- me inspektimin e transportit të mallrave si dhe inspektimin e transportit të mallrave të rrezikshme,
- me inspektimin e dokumentacionit të operatorëve të cilët ushtrojnë veprimtarinë e bartjes publike me autobus, etj.

Ka qenë pjesë e komisionit për ndryshime të vogla në Drejtorinë e Urbanizmit, pjesë e komisionit për pranime teknike të lokale, pjesë e komisionit për hartimin e rregullores për parkimet në komunën e Gjiçanit, etj... Janë marrë edhe me shqyrtimin e kërkesave të palëve.

Po ashtu ka ndihmuar edhe në mbajtjen e protokollit intern si dhe ka ndihmuar inspektorët e tjerë në sferën e shërbimeve publike, mbrojtjen e mjedisit si dhe tregut.

- 53 procesverbale të hartuara
- 14 kundërvajtje
- 9 kërkesa

Sfera e Mbrojtjes së Mjedisit

Inspektori i Mbrojtjes së Mjedisit është angazhuar në inspektimin zakonshëm për shqyrtimin e ankesave verbale, zyrtare si dhe inspektimet rutinore në bazë të planit të punës.

Është marrë me shqyrtimin e ankesave zyrtare dhe verbale që kanë të bëjnë me hedhje të mbeturinave, ndezje të mbeturinave, inspektim për Leje Mjedisore Komunale.

Të hyrat në Drejtorinë e Inspeksionit për tremujorin e parë të vitit 2023 janë 6.371,3€.